



KOMUNIKATË PËR SHITYP
31 maj 2017
KSC8-17

Referimi i dytë i Rregullores së Procedurës dhe të Provave Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese

Sot, Kryetarja e Dhomave të Specializuara, gjykatëse Ekaterina Trendafilova, i referoi Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese Rregulloren e Procedurës dhe të Provave pas rishikimit të saj prej gjykatësve të mbledhur në seancë plenare në muajin maj.

Referimi bëhet pas rishikimit të nëntë prej 208 rregullave në bazë të Aktvendimit të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese të datës 26 prill 2017.

Rregullat 19, 31, 32, 33, 35, 36, 38, 54, dhe 158, në formën e rishikuar përfshijnë konstatimet e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me pajtueshmërinë e tyre me standardet më të larta të të drejtave të njeriut dhe në përputhje me Kushtetutën e Kosovës. Këto rregulla trajtojnë mungesën e gjykatësve dhe vijimin e procedurave, masat hetimore që merr Prokurori i Specializuar, rivlerësimin e masës së mbajtjes në paraburgim dhe lirim të personave të shpallur të pafajshëm nga një trup gjykues.

Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese ka deri në 30 ditë për rishqyrtimin e Rregullores për të siguruar përputhshmërinë e saj me Kapitullin II, përfshirë nenin 55, të Kushtetutës që garanton të drejtat themelore. Nëse konfirmohet, Rregullorja do të hyjë në fuqi shtatë ditë pas vendimit të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese. Pas hyrjes në fuqi të Rregullores, Dhomat e Specializuara do të funksionalizohen tërësisht në aspektin gjyqësor dhe do të jenë të gatshme për kryerjen e procedurave gjyqësore.

[Referimi](#) është i disponueshëm për publikun në faqen e Dhomave të Specializuara në Internet (aktualisht vetëm në anglisht).

Për më shumë informacion mbi Dhomat e Specializuara të Kosovës, shkoni në: www.scp-ks.org.

KONTAKT: Njësia e Dhomave të Specializuara për Informim dhe Komunikim me Publikun në mediaKSC@scp-ks.org, tel: +31(0)6 249 21 036